

VENDIM
Nr. 2, datë 22.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 4.8.2017, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE TË MASËS SË TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT, NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV”

Në zbatim të nenit 156, nenit 142 e në vijim, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të pikës 4 dhe 5, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.1.2017, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; të vendimit nr. 2, datë 20.4.2017, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve të vendimit nr. 3, datë 4.8.2017, “Për miratimin e metodologjisë dhe të masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”, në Republikën e Shqipërisë, sipas relacionit shpjegues, të aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën kompetente brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Afati i ankimit, llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETARI
Ines Muçostepa

RELACION

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 4.8.2017, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE TË MASËS SË TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT, NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV

HYRJE

BAZA LIGJORE DHE FUSHA E ZBATIMIT

- Tarifat dhe metodologjia e përcaktimit të tyre miratohen me vendim të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), në zbatim të nenit 142 e vijues, të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
- Vendimi i KKDA-së për caktimin e tarifave dhe të metodologjisë bazohet në parimet e nenit 142 dhe 149, të ligjit 35/2016.
- Vendimi i KKDA-së është i zbatueshëm për të gjitha subjektet përdoruese në Shqipëri të veprave të mbrojtura të së drejtës së autorit, vepra këto që administrohen nga sporteli unik/agjencitë e administrimit kolektiv (AAK), të licencuara me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit.

- Vendimi i KKDA-së zbatohet në tërësi për tarifat dhe metodologjinë e tyre për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

OBJEKTIVI I KKDA-së NË ROLIN E RREGULLATORIT, MIRATIMI DHE ZBATIMI I METODOLOGJISË

Në zbatim të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. , datë 18.1.2017, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”, qëllimi kryesor i veprimtarisë së KKDA-së është garantimi dhe mbrojtja e mbajtësve të së drejtës, subjekt të së drejtës së autorit, si dhe miratimi i metodologjisë dhe i masës së tarifave të shpërblimit, mbi shfrytëzimin e veprave të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to, në administrimin kolektiv, si dhe në ushtrimin e kompetencave të tjera.

Ky Këshill, i cili përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga ministri i Kulturës, ka vendimmarrje për metodologjinë e tarifave të shpërblimit, duke u bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, qeverisjes së mirë, duke zhvilluar dëgjesa me të gjithë aktorët e interesuar. Këto tarifa do të qëndrojnë në fuqi për dy vite, duke i dhënë fund abuzimeve të deritanishme në tregun e produktit artistik.

HISTORIKU

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zbatim të pikës 4/a, të nenit 156, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ka miratuar vendimin nr. 3, datë 3.8.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e , “Për miratimin e metodologjisë dhe të masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”.

Në zbatim të nenit 147, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, subjektet përdoruese si më poshtë:

Grupi i parë:

- Top Channel;
- TV Klan;
- Digitalb;
- Media Vizion;
- ADTN;
- RTSH;

Grupi i dytë:

- Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizë Kabllorë Valorë.

Grupet e përmendura më lart u janë drejtuar gjykatës kompetente, brenda afatit të përcaktuar, ku Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit ishte palë e paditur.

Procesi gjyqësor ka kaluar shkallët e gjykimit dhe rezultoi se Gjykata e Administrative e Apelit, Tiranë ka vendosur, konkretisht: Për pezullimin e procesit gjyqësor, me qëllim rivlerësimin dhe negociimin e përmbajtjes së vendimit nr. 3, datë 4.8.2017.

Për rrjedhojë, subjektet e lartpërmendura kanë depozituar pranë Ministrisë së Kulturës kërkesat respektive, si më poshtë:

1. Kërkesa e Top Channel, Tv Klan, Digitalb, Media Vizion, ADTN, RTSH, datë 24.4.2018, me lëndë: “Kërkesë për ndryshimin e aktit administrativ (normativ), vendimit nr. 3, datë 4.8.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, “Për miratimin e metodologjisë dhe të masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”.

2. Kërkesa e shoqatës “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” depozituar në protokollin e Ministrisë së Kulturës me nr. 7355, datë 10.11.2017, me lëndë: “Sugjerime për rishikimin e zbatueshmërisë së metodologjisë dhe të tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit”. Kjo shoqatë i është drejtuar KKDA-së për rishikim tarifash por nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor.

KKDA-ja është mbledhur në datën 11.12.2017, me kërkesën e BTSH-së (mungon procesverbali i mbajtur nga z. Ahmeti).

3. Kërkesa e shoqatës “Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë” depozituar në protokollin e Ministrisë së Kulturës me nr. prot. 22, datë 11.5.2018, me lëndë: “Propozime për metodologjinë dhe për masën e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”.

Në shqyrtim të kërkesave të lartpërmendura, Sekretariati Teknik i KKDA-së lajmëroi palët e interesuara, si dhe u caktua mbledhja e radhës në datën 14.5.2018, me objekt: “Shqyrtimin e kërkesave të palëve”.

Në takimin e datës 14.5.2018, u dëgjuan palët në proces dhe të gjitha provat dhe pretendimet e tyre u morën në shqyrtim nga KKDA-ja.

NË VIJIM:

KKDA-ja, me vendimin nr. 1, datë 15.5.2018,, ka caktuar anëtarin e KKDA-së, z. Plarent Ndreca, si përfaqësues me autorizim, për rishikimin e propozimeve mbi sistemin tarifar, duke marrë për bazë të gjitha pretendimet e parashtruara nga palët, si dhe caktimin e tij për të kryer seanca dëgjimore në nivel më teknik, së bashku me sekretariatin teknik të KKDA-së.

Në datën 24.5.2018, u zhvillua seanca dëgjimore me palët e interesuara, ku me urdhër të KKDA-së, z. Ndreca ishte përfaqësuesi i caktuar nga KKDA-ja për të diskutuar mbi të gjitha pikat dhe ndryshimet që palët kanë kërkuar.

Nga takimet e zhvilluara, kërkuessit kanë ngritur pretendime në lidhje me propozimet e mundshme në metodologjinë e tarifave. Kërkuessit, si më poshtë vijojnë:

PRETENDIMET E PALËVE DHE KËRKESAT E TYRE PËR NDRYSHIME

- Top Channel;
- TV Klan;
- Digitalb;
- Media Vizion;
- ADTN;
- RTSH.

Në kreun I, pika 3, të “Metodologjisë së tarifave”, kërkohet ndryshimi në tërësi, si më poshtë. Përkufizimi në metodologjinë e tarifave është:

1. **“Të ardhura bruto”** nënkupton të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit.

Nuk përfshihen në të ardhurat bruto nga veprimtaria vjetore e përdoruesit:

- a) Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si shitja e mallrave dhe e produkteve;
- b) Të ardhurat nga reklama për prodhime të vetë OSHMA-ve;
- c) Të ardhurat që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënieve të punësimit;
- ç) Të ardhurat që krijohen nga sponsorizime, financime, kredi, grante, të lidhura dhe të ngjashme;
- d) Të ardhurat nga veprat për të cilat subjekti përdorues ka paguar në mënyrë direkte jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- dh) Të ardhurat që krijohen nga shitja ose distribucioni i të drejtave mbi programet e veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- e) Të ardhurat nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, kosto të tjera që lidhen me pagesa për licencime, si OSHMA që nuk lidhen me përdorimin e veprës së mbrojtur nga ligji;
- ë) Të ardhurat që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet, shitja ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- f) Të ardhurat që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit për të cilat subjekti përdorues hyn në marrëdhënie direkte me autorin/mbajtësin e të drejtave;
- g) Të ardhurat që krijohen nga blerja dhe shitja e veprave/enteve që nuk mbrohen nga ligji.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

Në kreun 1, pika 3, te të ardhurat bruto, duhet të specifikohet se te këto “të ardhura bruto”, nuk duhet të përfshihen:

“Të ardhurat bruto” nënkupton “të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, të deklaruara në pasqyrat financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të përdoruesit, sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor dhe atij kontabël në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Nuk duhet të përfshihen në të ardhurat bruto:

1. Të gjitha të ardhurat nga aktivitete të tjera që kanë ose jo lidhje me aktivitetin kryesor për të cilin është licencuar subjekti, përdoruesi i veprës së mbrojtur dhe të ardhura të cilat për nga natyra e tyre nuk rrjedhin nga përdorimi i veprave të mbrojtura;

2. Në rastin e transmetimeve radiotelevizive të OSHMA-së së licencuar sipas legjislacionit në fuqi për mediat audiovizive:

a) Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si shitje e mallrave dhe e produkteve;

b) Shumat e arkëtuara për prodhimin/ financimin e një programi audioviziv të porositur nga një OSHMA;

c) Rimarrjen e çdo shume të paguar për të marrë të drejtat ekskluzive kombëtare ose lokale të transmetimit të një ngjarjeje sportive, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e sporteve dhe aktiviteteve të tjera në shërbim të tyre, që nuk përdorin vepra me të drejtë autori; nëse OSHMA-ja mund të vërtetojë se ka paguar dhe tarifa normale për kohën dhe pajisjet e stacionit, si dhe të ardhura nga kostot teknike të transmetimit; duke përfshirë këtu dhe të ardhurat nga reklamat gjatë eventeve të ngjarjeve sportive;

d) Të gjitha të ardhurat nga reklamat për prodhime të vetë OSHMA-ve, reklama këto të transmetuara para, gjatë dhe në fund të këtyre prodhimeve;

e) Të gjitha të ardhurat që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënies së punës;

f) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga sponsorizime, financime, kredi, grante, të lidhura apo të ngjashme;

g) Të gjitha të ardhurat për vepra të mbrojtura, për të cilat OSHMA-ja ka paguar direkt jashtë territorit të RSH-së, sipas marrëveshjeve me mbajtësit e së drejtës;

h) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga shitja ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-së, brenda dhe jashtë RSH-së;

i) Të gjitha të ardhurat nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, të ardhurat nga dhënia me qira të ambienteve apo të pasurive (të luajtshme, të paluajtshme), kosto të tjera që lidhen me pagesa licencimi, si OSHMA-ja që nuk lidhen me përdorimin e veprave në mbrojtje të së drejtës së autorit;

j) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet shitje ose distribucion i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të veta të OSHMA-së, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së;

k) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit, për të cilat përdoruesi (OSHMA) hyn në marrëdhënie direkte me autorin/me mbajtësin e së drejtës për administrimin kolektiv të detyrueshëm, kur të gjitha palët kontraktore kanë hequr dorë nga ky administrim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;

l) Në rastin e OSHMA-së me pagesë (*pay TV*) të paketave të abonimit dhe të eventeve, paguaj për ta parë (*pay-per-view*), të ardhurat nga këto të fundit vlerësohen në raport me përdorimin e veprës së mbrojtur dhe jo si e ardhur në tërësi. Në rastet kur kjo e ardhur nuk ka mundësi të përcaktuar vlerësohen kostot e blerjes së veprave të mbrojtura nga mbajtësi i së drejtës;

m) Në rastin e transmetuesit publik audioviziv RTSH, të ardhurat që krijohen nga financimi i buxhetit të shtetit për zërat e parashikuar në nenin 116, të ligjit 97/2013 dhe të ardhurat që vijnë nga tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit marres televiziv, sipas nenit 115, të ligjit 97/2013, si dhe nenit 99, 75,

datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”;

n) Për OSHMA-të përsëritë apo ritransmetues të sinjalit të një OSHMA-je tjetër në kohë reale, të ardhurat bruto konsiderohen ato të përfituara direkt nga këto të fundit, duke përjashtuar atë pjesë të së ardhurës që paguhet direkt të mbajtësit e të drejtave që ofrojnë të drejtat e ritransmetimit;

o) Të ardhurat që krijohen nga blerja ose shitja e veprave/eventeve që nuk mbrohen nga ligji.

Në kreun I, pika 14, të “Metodologjisë së tarifave” kërkohet ndryshimi i përkufizimit, si më poshtë:

Përkufizimi në metodologjinë e tarifave është:

“Abonim”, nënkuptohet kontrata e shërbimit lidhur midis ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) me pagesë dhe marrësit të këtyre shërbimeve”.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

“Abonim”, nënkuptohet kontrata e shërbimit, lidhur midis ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) me pagesë dhe marrësit të këtyre shërbimeve dhe çdo përdoruesi tjetër që sipas ligjit është i detyruar të lidhë një kontratë abonimi me publikun apo me klientin”.

Në kreun II, tabela 1 të “Metodologjisë së tarifave”, kërkohet ndryshimi si më poshtë:

Paraqitja në tabelë është:

Tarifa në përqindje mbi të ardhurat bruto vjetore është:

- Për kohëzgjatjen deri në 35%, tarifa në përqindje është 2%.
- Për kohëzgjatjen 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 3%.
- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 4%.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen nga 11 deri në 35% të kohës ditore, tarifa në përqindje është 0.79%.

- Për kohëzgjatjen 36 deri në 65% të kohës ditore, tarifa në përqindje është 0.9%.

- Për kohëzgjatjen mbi 65% të kohës ditore, tarifa në përqindje është 1.2%.

Në kreun II, tabela 2, të “Metodologjisë së tarifave”, kërkohet ndryshimi si më poshtë:

Paraqitja në tabelë është:

Tarifa në përqindje, aplikuar mbi të ardhurat bruto vjetore mbi kufirin prej 5 milionë lekësh, është:

- Për kohëzgjatjen deri në 35%, tarifa në përqindje është 1%.
- Për kohëzgjatjen 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 2%.
- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 3%.

Formula e llogaritjes së tarifës llogaritet përqindja e përcaktuar më lart + tarifën fikse kur të ardhurat bruto janë mbi 5 milionë.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 35%, tarifa në përqindje është 0.79%.

- Për kohëzgjatjen 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 0.9%.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 1.2%.

Në kreun III, tabela 1, të “Metodologjisë së tarifave”, kërkohet ndryshimi si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 10%, tarifa në përqindje është 1% e të ardhurave bruto.

- Për kohëzgjatjen nga 11 deri në 35%, tarifa në përqindje është 2% e të ardhurave bruto.

- Për kohëzgjatjen nga 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 3% e të ardhurave bruto.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 4% e të ardhurave bruto.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 10%, tarifa në përqindje është 0.6% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen nga 11 deri në 35%, tarifa në përqindje është 0.7% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen nga 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 0.8% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 1% e të ardhurave bruto vjetore.

Në kreun III, seksioni II, tabela 2 e “Metodologjisë së tarifave” kërkohet ndryshimi si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 10%, tarifa në përqindje është 1% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

- Për kohëzgjatjen nga 11 deri në 35%, tarifa në përqindje është 2% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

- Për kohëzgjatjen nga 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 3% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 4% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 10%, tarifa në përqindje është 0.6% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen nga 11 deri në 35%, tarifa në përqindje është 0.7% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen nga 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 0.8% e të ardhurave bruto vjetore.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 1% e të ardhurave bruto vjetore.

Në kreun III, seksioni II, tabela 4, e “Metodologjisë së tarifave” kërkohet ndryshimi si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen deri në 35%, tarifa në përqindje është 2% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

- Për kohëzgjatjen nga 36 deri në 65%, tarifa në përqindje është 3% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 4% e të ardhurave bruto plus tarifën fikse për të ardhurat mbi kufirin 5 milionë.

Kërkohet të ndryshohet si më poshtë:

- Për kohëzgjatjen nga 0.1% deri në 10%, tarifa në përqindje është 0.79% e të ardhurave bruto vjetore për OSHMA-të përsëritës, ndërsa për OSHMA-ofrues programi audioviziv, tarifa në përqindje është 0.6%.

- Për kohëzgjatjen deri në 35%, tarifa në përqindje është 0.79% e të ardhurave bruto vjetore për OSHMA-të përsëritës, ndërsa për OSHMA-ofrues programi audioviziv, tarifa në përqindje është 0.7%.

- Për kohëzgjatjen nga 36% deri në 65%, tarifa në përqindje është 0.79% e të ardhurave bruto vjetore për OSHMA-të përsëritës, ndërsa për OSHMA-ofrues programi audioviziv, tarifa në përqindje është 0.8%.

- Për kohëzgjatjen mbi 65%, tarifa në përqindje është 0.79% e të ardhurave bruto vjetore për OSHMA-të përsëritës, ndërsa për OSHMA-ofrues programi audioviziv, tarifa në përqindje është 1%.

Në kreun VI, tabela 1, të “Metodologjisë së tarifave”, shtojnë sqarimet për pikën 6 (markete supermarkete) si më poshtë:

- Në rastin e përdorimit të veprave të mbrojtura në ambientet tregtare të OSHMA-ve, nuk aplikohen këto tarifa, pasi këto ambiente nuk kanë për qëllim përdorimin e veprës së autorit, por shitjen e mallrave dhe produkteve të OSHMA-ve, si dhe për këto transmetime është paguar nga OSHMA-ja si përdorues.

Në kreun VII, seksioni II, (Transporti) të “Metodologjisë së tarifave”, të shtohet pika 4 si më poshtë:

- Në rastin e përdorimit të veprave të mbrojtura në mjetet e transportit dhe terminalët, nuk aplikohen këto tarifa, nëse pronari/organizatori ka paguar direkt mbajtësin e të drejtave për eventin që organizon.

Në kreun VII, seksioni III, pika 1 (Kinematë) të metodologjisë së tarifave, të shtohet paragrafi i dytë dhe i tretë si vijon:

- Në rastin e përdorimit të veprave të mbrojtura në kinema, nuk aplikohen këto tarifa, nëse kinemaja ka paguar direkt mbajtësin e të drejtave të veprave që transmeton;

Këtu përdoret e njëjta analogji si në rastin e shembujve të përdorur për TV-të kombëtare dhe private.

Në kreun VII, seksioni III, pika 3 (Mjedise sportive dhe të tjera), të “Metodologjisë së tarifave”, të shtohet pika 5 si vijon:

- Në rastin e përdorimit të veprave të mbrojtura në ambientet publike, mjedise sportive/të tjera, nuk aplikohen këto tarifa nëse pronari/organizatori ka paguar direkt mbajtësin e të drejtave për eventin që

organizon.

Shtimi i kreut VIII, me përmbajtje si vijon:

Kreu VIII

Kontrata tip mes AAK-ve dhe përdoruesit

Këtij vendimi i bashkëlidhet një format tip i kontratës mbi marrëveshjen gjithëpërfshirëse për tarifën vjetore, që do të lidhet me sportelitetin unik të AAK-ve dhe përdoruesit. Ky draft tip plotësohet sipas negociatave me palëve.

PRETENDIMET E BASHKIMIT TREGTAR TË SHQIPËRISË

BSHT-ja pretendon se tarifën janë të larta, madje tepër të larta, dhe nuk ka një ndarje midis tarifës për një supermarket në Tiranë apo një supermarket në Pogradec, as një ndarje nga numri i klientëve, fuqia blerëse apo xhiroja vjetore.

BSHT-ja kërkon rishikimin e kreut VI, “Tarifa për komunikimin në publik të veprës së mbrojtur në njësi tregtare dhe mjedise të tjera biznesi”.

Dhe kërkon, konkretisht, që:

1. Të paguhet një vlerë jo më shumë se 20% e tarifës ekzistuese të parashikuar në vendimin nr. 3, datë 4.8.2017, të KKDA-së. Pra kërkojnë një ulje prej – 80% të tarifës.
2. Klasifikim të diferencuar sipas qarqeve e përllogaritjeve, në bazë të numrit të popullsisë siç është vepruar dhe në rastet e tjera të këtij vendimi.
3. BTSH-ja propozoi që të sillte një propozim konkret mbi pretendimet e saj, por deri më sot nuk ka depozituar asnjë dokument pranë KKDA-së apo MK-së.

PRETENDIMET E SHOQATËS SË TRANSMETUESVE RADIOTELEVIZIVË KABLLORË VALORË

SHRTL-ja kërkon që masa e tarifës së shpërblimit kundrejt AAK-ve, në rastin e veprave të shfrytëzuara nga ritransmetuesit kabllorë, të jetë një vlerë fikse, konkretisht **1 për qind e fitimit të realizuar** nga këto subjekte, si pasojë e përdorimit të veprave në programe dhe transmetime televizive që këta ritransmetues përcjellin te pajtimtarët e tyre dhe jo **1 për qind të të ardhurave bruto vjetore, siç është e parashikuar në metodologjinë e tarifave**, pasi një kabllor ka në NIPT-in e tij dhe shërbime të tjera të aktiviteteve të ndryshme tregtare që nuk lidhen me të drejtën e autorit.

Së pari, të ardhurat bruto vjetore të një subjekti kabllor valor duhet të përjashtohen:

- Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si p.sh., shitja e mallrave dhe e produkteve;
- Të ardhura nga reklama për prodhime të vetë OSHMA-së;
- Të ardhura që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënieve të punësimit;
- Të ardhura që krijohen nga sponsorizime financime, kredi, grante, të lidhura dhe të ngjashme;
- Të ardhura me vepra për të cilat përdoruesi ka paguar direkt jashtë territorit të RSH-së;
- Të ardhura nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, kosto të tjera që lidhen me pagesa licencimesh, si OSHMA-ja, që nuk lidhen me përdorimin e veprës së mbrojtur sipas ligjit;
- Të ardhura që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet, shitje ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe paketave me programe të vetë OSHMA-së, brenda dhe jashtë RSH-së;
- Të ardhura që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit, për të cilat përdoruesi hyn në marrëdhënie direkte me autorin/mbajtësin e së drejtës;
- Të ardhurave që krijohen nga blerja ose shitja e veprave/eventeve që nuk mbrohen nga LDA-ja.

ANEKSI 1

Tiranë, më 22.6.2018

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

VENDOSI:

I. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së palës kërkuese të OSHMA-ve, duke përjashtuar nga të ardhurat bruto, listën e mëposhtme:

1. Të gjitha të ardhurat nga aktivitete të tjera që kanë ose jo lidhje me aktivitetin kryesor për të cilin është licencuar subjekti, përdoruesi i veprës së mbrojtur dhe të ardhura të cilat për nga natyra e tyre nuk rrjedhin nga përdorimi i veprave të mbrojtura;

2. Në rastin e transmetimeve radiotelevizive të OSHMA-së së licencuar, sipas legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive:

a) Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si shitje e mallrave dhe e produkteve;

b) Shumat e arkëtuara për prodhimin/për financimin e një programi audioviziv të porositur nga një OSHMA;

c) Rimarrjen e çdo shume të paguar për të marrë të drejtat ekskluzive kombëtare ose lokale të transmetimit të një ngjarjeje sportive, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e sporteve dhe të aktiviteteve të tjera në shërbim të tyre, që nuk përdorin vepra me të drejtë autori; nëse OSHMA-ja mund të vërtetojë se ka paguar dhe tarifa normale për kohën dhe pajisjet e stacionit, si dhe të ardhura nga kostot teknike të transmetimit; duke përfshirë këtu dhe të ardhurat nga reklamat gjatë eventeve të ngjarjeve sportive;

d) Të gjitha të ardhurat nga reklamat për prodhime të vetë OSHMA-ve, reklama këto të transmetuara para, gjatë dhe në fund të këtyre prodhimeve;

e) Të gjitha të ardhurat që sigurohen nga përdorime të veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënies së punës;

f) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga sponsorizime, financime, kredi, grante, të lidhura apo të ngjashme;

g) Të gjitha të ardhurat për vepra të mbrojtura, për të cilat OSHMA-ja ka paguar direkt jashtë territorit të RSH-së, sipas marrëveshjeve me mbajtësit e së drejtës;

h) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga shitja ose distribucioni i të drejtave të programeve të veta dhe i paketave me programe të vetë OSHMA-së, brenda dhe jashtë RSH-së;

i) Të gjitha të ardhurat nga investimet, projektet teknike të zhvillimit, të ardhurat nga dhënia me qira e ambienteve apo e pasurive (të luajtshme, të paluajtshme), kosto të tjera që lidhen me pagesa licencimi si OSHMA-ja, që nuk lidhen me përdorimin e veprave në mbrojtje të së drejtës së autorit;

j) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga publikimi në mediat sociale/internet shitje ose distribucion i të drejtave të programeve të veta dhe i paketave me programe të veta të OSHMA-së, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së;

k) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga përdorimi i të drejtave të autorit, për të cilat përdoruesi (OSHMA) hyn në marrëdhënie direkte me autorin/mbajtësin e së drejtës për administrimin kolektiv të detyrueshëm, kur të gjitha palët kontraktore, kanë hequr dorë nga ky administrim, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;

l) Në rastin e OSHMA-së me pagesë (*pay TV*) të paketave të abonimit dhe të eventeve, paguaj për ta parë (*pay-per-view*), të ardhurat nga këto të fundit vlerësohen në raport me përdorimin e veprës së mbrojtur dhe jo si e ardhur në tërësi. Në rastet kur kjo e ardhur nuk ka mundësi të përcaktuar vlerësohen kostot e blerjes së veprave të mbrojtura nga mbajtësi i së drejtës;

m) Në rastin e transmetuesit publik RTSH, përjashtohen vetëm të ardhurat sipas pikës “ç” të nenit 116, të ligjit 97/2013;

n) Për OSHMA-të përsëritës/apo ritran-smetues të sinjalit të një OSHMA-je tjetër në kohë reale, të ardhurat bruto konsiderohen ato të përfituara direkt nga këto të fundit, duke përjashtuar atë pjesë të së ardhurës që paguhet direkt te mbajtësit e të drejtave që ofrojnë të drejtat e ritransmetimit;

o) Të ardhurat që krijohen nga blerja ose nga shitja e veprave /e eventeve që nuk mbrohen nga ligji.

II. Rrëzimin e pjesës tjetër të kërkesës së palës kërkuese OSHMA, si e pabazuar në ligj dhe prova.

III. Rrëzimin e kërkesave të palëve kërkuese, Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë, si dhe Bashkimit Tregtar të Shqipërisë, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

IV. Në tabelën 4, të kreut III, të vendimit nr. 3, datë 4.8.2017, përcaktohet se përqindja do të zbatohet vetëm mbi diferencën e të ardhurave mbi 5 milionë lekë.

Kundër këtij vendimi të KKDA-së, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Afati i ankimit llogaritet nga data e komunikimit të këtij vendimi, palëve në këtë proces.